

RAPORT PËR SHËRBIMET LIGJORE FALAS TË OFRUARA NË KUADËR TË KLINIKËS LIGJORE JANAR-SHTATOR 2008

1. Komitetit Shqiptar i Helsinkit (KShH), organizata e parë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirve themelore të njeriut, prej vitit 2007 po zbaton programin “Klinika Ligjore Falas”, financuar nga Komiteti Suedez i Helsinkit. Objektivi kryesor i projektit është mbrojtja e të drejtave të grupeve të pambrojtura të shoqërisë shqiptare, kur të drejtat e tyre shkelen nga përfaqësues të institucioneve shtetërore.
2. Tre grupet kryesore ku është fokusuar programi janë: personat të cilët janë viktimat të ushtrimit të dhunës, të trajtimeve dhe degradimeve ç’njerëzore, të kryera nga punonjësit e policisë, personeli i vendeve të paraburgimit dhe burgjeve; personat të cilët janë viktimat të diskriminimit nga punonjës të institucioneve shtetërore në përgjithësi, personat që i përkasin minoritetit rom dhe komunitetit egjiptian në veçanti dhe personat të cilët janë cënuar nga e drejta për të pasur një proces të rregullt ligjor.
3. Gjatë periudhës janar-shtator 2008 janë trajtuar 969 ankesa¹, të paraqitura nga 437 ankues. Sipas vendbanimit, ankesat kanë ardhur nga zona të ndryshme të Shqipërisë. Numri më i madh i ankesave është nga qytetet me numër të madh popullsie. Sipas gjendjes sociale të ankuesve, ankesat kanë ardhur nga persona në gjendje të lirë, nga persona të paraburgosur në institucionet e paraburgimit, nga persona të burgosur që vuajnë dënimet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, nga persona të shoqëruar/ndaluar në komisariatet e policisë.
4. Ankesat dhe kërkesat janë adresuar në KSHH në rrugë të ndryshme si: takimi në zyrë, letra, e-mail, telefon dhe pjesa tjetër janë mes vëzhgimeve në vend. Vëzhgimet janë kryer për të parë respektimin e të drejtave të personave me liri të kufizuar (persona të paraburgosur, të burgosur, persona të ndaluar/shoqëruar), minoritetit Rom dhe komunitetit Egjiptian. Vëzhgimet kanë qënë të planifikuara dhe sporadike.
5. Objekt i vëzhgimeve të planifikuara kanë qënë dhomat e ndalimit, të shoqërimit në komisariatet e policisë, institucionet e paraburgimit dhe ekzekutimit të

¹ Të dhënat bazohen në numrin e ankesave dhe të kërkesave të ardhura dhe jo në numrin e ankuesve. Nje përsos mund të këtë adresuar më shumë se një ankesë gjatë vitit ose në ankesat e tij ka paraqitur ankesa për më shumë se një problem ose institucion.

- vendimeve penale, disa prej zonave ku ka përqëndrime të minoritetet rom ose komunitetit Egjyptian.
6. Vëzhgimet sporadike janë kryer gjatë gjithë periudhës janar-shtator 2008. Vëzhgimet kanë lindur si domosdoshmëri për verifikimin e ankesave të ardhura në KShH nga persona me liri të kufizuar dhe që kanë pretenduar për shkelje të të drejtave të tyre.
 7. Gjatë periudhës janar- shtator 2008, ankesat janë paraqitur/marrë nga grupi i vëzhgimit. Grupi i vëzhgimit ka përcjellë ankesat e personave të pambrojtur të cilët për shkaqe të ndryshme si: liria e kufizuar, gjendja shëndetësore ose social-ekonomike, mungesa e informacionit, nuk kanë patur mundësi për të sjellë vetë ankesën e tyre në zyrat e KShH-së; Vetë ankuesit ose të afërmit e ankuesve të cilët kanë sjellë ankesa në emër të personave që u është kufizuar liria; Korrespondentët e KShH-së (Shkodër, Elbasan, Fier, Korçë dhe Gjirokastër. Ata kanë përcjellë ankesat e atyre qytetarëve që nuk banojnë në Tiranë dhe nuk kanë patur mundësi të paraqiten në zyrat tona. Organizatat me të cilat KShH bashkëpunon si TLAS, FSHDPAK, Sfinksi. Avokatët e ankuesve dhe Informacionet e botuara në media.
 8. Ankesat kanë patur objekt të ndryshëm. Lidhur me trajtimin e personave në vendet e paraburgimit dhe burgjet, ankesat kanë të bëjnë me shkelje të të drejtave në burgje/paraburgim, kërkesa për transferime ose mostransferim, ankesa për ushtrim dhune fizike ose psikologjike nga personeli i burgjeve ose për mënyrën e trajtimit të konflikteve mes të burgosurve /paraburgosurve.
 9. Gjatë periudhës që mbulon raporti, KSHH ka marrë ankesa ku shtetasit kanë pretenduar për veprime të padrejta nga organet e policisë si; ndalime të pajustificuara, mbajtje pa të drejtë në dhomat e ndalimit/shoqërimit, qëndrim jashtë afateve të parashikuara në ligj, mosvënja në dijeni për të drejtat e tyre në momentin e ndalimit/shoqërimit, kushte të këqija të dhomave të ndalimit/arrestimi, ushtrim dhune psikike dhe fizike nga forcat e policisë.
 10. Shtetasit janë ankuar për veprimet e organit të prokurorisë. Ata kanë pretenduar për pushim të padrejtë të procedimit penal nga organi i prokurorisë, mosinformim lidhur me ecurinë e hetimeve, pretendime për akuza të pabaza nga prokuroria gjatë procesit të hetimit, mospranim i kallzimit nga prokuroria.
 11. Gjatë periudhës të analizuar janë trajtuar ankesa për proces të parregullt ligjor si: mohim i së drejtës për të patur avokat, pabarazi mjetesh juridike në procesin penal, mosnjohim i familjes së të miturit në procesin penal, zvarritje e procesit gjyqësor; pretendime për vendime të padrejta gjyqësore dhe për pafajësi; mosekzekutim të vendimeve gjyqësore nga zyra e shërbimit përmbarimor; mospërfitim i statusit të dëshmitarit.

12. KShH-ja ka trajtuar kërkesa dhe ankesa lidhur me mosmarrjen e ndihmës ekonomike/pensionet, veprime të padrejta dhe procedura jo transparente nga organet e administratës qendrore dhe vendore, ankesa për dhunë në familje, zgjidhje e martesave, ankesa për mosregjistrimin e fëmijëve, çështje pronësie, probleme të strehimit; punësimit, diskriminim i fëmijëve në shkolla; kërkesa për më shumë programe sociale për të rinjtë dhe të moshuarit, mungesa e ambulancave, qendrave shëndetësore, kopshteve dhe shkollave, probleme të infrastrukturës si: shtrim rrugësh, mungesë kanalizimesh, mungesë dritash, ujë i pijshëm, kërkesa për pastrimin e ambienteve ku jetojnë. Përsa i përket ankesa lidhur me marrëdhëniet e punës, kryesisht ankesat kanë ardhur për lëvizje të padrejtë nga puna.
13. Në kuadër të klinikës ligjore, KSHH-ja ka ofruar edhe shërbime ligjore të tjera falas si: asistencë për plotësim dokumentash, këshillim ligjor, monitorim të proceseve gjyqësore, adresim i problemeve në institucionet shtetërore dhe verifikime.
14. Komunikimi me institucionet e ndryshme shtetërore për trajtimin e ankesave ka qenë korrekt. Në përgjithësi, ato bashkëpunojnë dhe i përgjigjen kërkesave të drejtuara nga KSHH-ja. Në raste të shkeljeve të rënda, KShH-ja ka reaguuar publikisht duke shprehur shqetësimin për problemet e konstatuara dhe u ka kërkuar institucioneve shtetërore të marrin masat e nevojshme për përmirësimin e gjendjes.